



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.0802-111
13.03.2024
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Vendimin PA1 nr.0802-69 datë 05.03.2024 për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO USKANA – PLUS eksport-import SHPKNJP Kërçovë, PA1 nr.08-105 datë 07.09.2023 dhe Konkluzionin me ark.nr.0201-1153/3 datë 12.03.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 9-të mbajtur më 13.03.2024 miratoi:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO USKANA – PLUS eksport-import SHPKNJP Kërçovë.
2. Ky aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), leja për transmetim televiziv ose radio, ndalon së vlefshmi sipas ligjit, me heqjen e lejes nga ana e Agjencisë. Në pajtim me paragrafin (2) nga neni i cituar i Ligjit, Agjencia do të fshin transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve nëse leja mbaron së vlefshmi në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në vazhdimin e parë të seancës së 8-të mbajtur më 04.03.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.0201-1054/12 datë 05.03.2024, miratoi Vendim PA1 nr.0802-69 datë 05.03.2024, me të cilën i hiqet leja Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO USKANA – PLUS eksport-import SHPKNJP Kërçovë, PA1 nr.08-105 datë 07.09.2023, për shkak se zotëruesi i lejes nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio në afatin e përcaktuar me Ligj - 30 ditë nga dita e pranimit të Faturës me nr.2024-100-0058 datë 11.01.2024. (nr ynë.ark.0503-227/1 datë 11.01.2024).

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lartë, dhe në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe paragrafi (2) të LSHMA-së, dhe në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar), Vendimin PA1 nr.0802-69 datë 05.03.2024 për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO USKANA – PLUS eksport-import SHPKNJP Kërçovë, PA1 nr.08-105 datë 07.09.2023 dhe Konkluzionin me nr.ark.0201-1153/3 datë 12.03.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 9-të mbajtur më 12.03.2024, miratoi vendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.